

DPK / DMP

03-357/2013

02

12.02.2013

REPUBLIKA E KOSOVËS
Gjykata Themelore Pejë – Dega në Klinë
Divizioni per Kundervajtje
Rexh.I.nr. 4093/2012

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Divizioni për Kundervajtje, në përbërje prej Gjyqtarit: Bajram Dreshaj, dhe Sek. Juridik: Galë Balija në procedurën kundërvajtëse ndaj të paraqiturës: **Filloreta Berisha, nga fsh. Gjurgjevik i Madh Komuna e Klinës, sipas Akvendimit mbi Abrogimin** me të njëjtin numër, për kundërvajtje nga neni 5.6.9. dhe neni 17 .të Ligjit nr.04 /L-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar, dhe neneve 30.123,195 dhe 198.al.1p. 8. të LMK-së, me datë 05.02.2013, merr këtë :

A k t v e n d i m

Pezullohet procedura kundërvajtëse konform nenit 198.al.1.p.8. të LMK-së, në mungesë të provave ndaj të paraqiturës : Filloreta Mujë Berisha, e lindur me dt. 17.06.1983, në fsh. Gjurgjevik i Madh ku dhe jeton Komuna e Klinës, Doktoresh e mjekësisë së Përgjithshme, e pa martuar, Këshilltare pranë Kuvendit Komunal në Klinë, gjeja e pa dënuar me parë për kundërvajtje nga neni 5.6.9. dhe 17. të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin dhe Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar, sepse e autorizuar - Kordinatorja: Remzije Maloku, të paraqiturit nuk ia ka dorëzuar Formularin mbi Deklarimin vjetor të Pasurisë dhe atë përmes Fletëdorzimit mbi datën e dorëzimit pranimit nga palët proceduse më nënshkrimin e dy anëshem .

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka parashtruar Kerkesën nr. 01- 2179/12, të datës 15.06.2012 për zhvillimin e procedurës Kundervajtës ndaj të paraqiturës : Filloreta Berisha.

Veç kësaj Gjykata zhvilloj procedurën e rregullt kundërvajtëse, ku pra në procedurën e të provuarit e paraqitura : **Filloreta Berisha**, në mbrojtjen e vetë të sances verbale, me dt. 25.01.2013, ka vërtetuar atë se nga e autorizuar- Kordinatorja: Remzije Maloku, nuk iu është dorëzuar fare Formulari mbi deklarimin vjetor të pasurisë dhe atë përmes Fletëdorzimit mbi datën e dorëzimit pranimit të palëve proceduese dhe atë me nënshkrimin e dy anëshem .

Metutje i paraqituri deklaron: se nese Formulari të iu kishte dorëzuar të njëjtin do ta plotësonte duke u bazuar në Ligj.

Deshmitarja: **Remzije Maloku**, në mbrojtjen e vetë të seances verbale me dt. 08.01.2013, nuk ka qenë në gjendje të vërtetoj atë që ia ka dorëzuar Formularin mbi deklarimin vjetor të pasurisë të paraqiturës : Filloreta Berisha dhe atë me anë të Fletëdorzimit dhe me nënshkrimin e dy palëve të pranim dorëzimit, por se atë e kam, ,, dorëzuar në menyrë eletronike dhe me telefon,,.

Ndërsa deshmitari: **Enis Sadiku**, Perfaqësues i Agjencisë kundër Korrupsionit me Autorizimin nr. 01-155/2013, të dt. 25.01.2013, nga Departamenti ZD/DPK në Prishtinë, i cili ka vërtetuar se Formularet janë dërguar për mes postës eletronike të pikës kontaktuese me të autorizuarën Ramzije Maloku .


Gjykata pas ndëgjimit të deklartës se të paraqiturit, deshmitarëve, dhe shiqimit të gjithave shkresave të tjera në lëndë, me procedimin e tyre si prova relevante dhe atyre një nga një, me lidhmerin e tyre reciproke, është vërtetuar se ato janë të mjaftshme, të besueshme dhe mjaftë bindse e konkrete, të përcaktuara për atë ku edhe në tërësi iu është falur besimi duke e **Pezulluar** procedurën kundërvajtës ndaj të paraqiturës : Filloreta Berisha e konform nenit 198.al.1.p.8 të

LMK-së, sipas Aktvendimit mbi Abrogimin me të njëjtin numër nga Gjykata e Lartë për Kundervajtje më marrjen e aktvendimit.
Me nga një kopje të aktvendimit të njoftohen: i paraqituri dhe parashtruesi i Kërkesës.

Këshilla Juridike

Palët e interesuara kundër këtij aktvendimi mund të ushtrojnë **Ankesë**, në afatin 8 (tetë ditor) nga dita e marrjes përmes kësaj Gjykate, për në Gjykatën Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni per Kundervajtje .

U vendos në Gjykatën Themelore Pejë- Dega ne Klinë, Divizioni për Kundervajtje , me datë 05.02.2013 dhe nr.regj. 4093/2012.



Gjyqtari
Bajram Dreshaj